






Komuna- Municipality
Hani i Elezit



Komuna- Municipality
Kaçanik



MARRËVESHTJE MIRËKUPTIMI PËR BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL

NË MES TË

KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

DHE

KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Nëntor 2020

1. Palët e marrëveshtjes

1. Komuna e Hanit të Elezit, adresa rruga “Nuri Bushi” nr. 2 në Han të Elezit dhe
2. Komuna e Kaçanikut, adresa rruga “Qamil Ilazi” në Kaçanik

2. Qëllimi i marrëveshjes

Kjo Marrveshje lidhet me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ndërkomunal si dy komuna fqinje dhe me qëllim të harmonizimit dhe realizimit të aktiviteteve të ndryshme në interes të qytetarëve të dy komunave.

3. Fushat e bashkëpunimit

1. Administratë komunale
2. Arsim, kulturë dhe sport
3. Shëndetësisë dhe mirëqenjes sociale
4. Mbrojtje te pasurive natyrore dhe të amientit

3.1. Administrat komonale

1. Këmbim i përvojave në realizimin e projekteve/aktiviteteve të ndryshme për shërbim cilësor të qytetarëve
2. Harmonizimi i aktiviteteve në hartimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme në interes të dy komunave
3. Harmonizimi i qarkullimit ndërkomunal të udhëtarëve
4. Harmonizimi i aktiviteteve/planeve për raste emergjente nga fatëkeqësit natyrore dhe mbojtja nga zjarret
- 5.

3.2. Arsim kulturë dhe sport

1. Këmbim i përvojave në realizimin e projekteve/aktiviteteve të ndryshme për zhvillim cilësor të procesit mësimor
2. Këmbim i përvojave në realizimin e projekteve/aktiviteteve të ndryshme për zhvillim profesional të personelit arsimor
3. Përfshirja e nxënësve në instucionet arsimore në klasat 1-9 nëse komuniteti i komunës tjetër e ka më afër apo dëshiron që fëmija në ndjek mësimet në atë institucion arsimor
4. Organizimi i transportit për nxënësit e klasave 1-9 të cilët vijojnë mësimin në shkollat e komunës tjetër që sipas ligjit për arsim parauniversitar është i obliguar transporti
5. Pranimi i nxënësëve nga komuna tjetër në shkollat e mesme të lartë në drtejtimet të cilat nuk janë në komunën amë

6. Pranimi i nxënësve në shkollat e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar të cilët për arsye disiplinore apo arsye tjetër është përjashtuar apo është larguar përkohësisht nga shkolla/t në komunën amë
7. Këmbim i përvojave në realizimin e projekteve/aktiviteteve të ndryshme për ruajtjen e trashigimisë kulturore
8. Këmbim i përvojave në realizimin e projekteve/aktiviteteve të ndryshme për zhvillimin e turizmit kulturor
9. Organizimi i aktiviteteve të përbashkta kulturore dhe sportive në nivel të dy komunave
10. Këmbim i përvojave dhe kuadrove në realizimin e projekteve/aktiviteteve të ndryshme në lëmin e sportit
11. Shfrytëzim i hapsirave/terreneve/sallave sportive nga ekipe të komunave të ndryshme me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve në nivele të ndryshme të sportit

3.3. Shëndetësisë dhe mirëqenjes sociale

1. Këmbim i përvojave në realizimin e projekteve/aktiviteteve të ndryshme për në shëndetësisë dhe mirëqenjes sociale
2. Këmbim i përvojave në realizimin e projekteve/aktiviteteve të ndryshme për zhvillim profesional të personelit shëndetësor
3. Dalja në ndihmë e ekipeve emergjente në situata të ndryshme të fatëkeqësive në komunikacion, fatëkeqësive natyrore apo situatave të ndryshme emergjente apo të jashtëzakonshme
- 4.

3.4. Mbrotja pasurive natyrore dhe të ambientit

1. Këmbim i përvojave në realizimin e projekteve/aktiviteteve të ndryshme për ruajtjen e pasurive natyrore dhe mbrojtje të ambientit
2. Këmbim i përvojave në realizimin e projekteve/aktiviteteve të ndryshme për zhvillim të turizmit malor dhe pasurive natyrore
3. Krijimi i shtigjeve të përbashkta për Hiking dhe turizëm malor
4. Ruajtja e pasurive natyrore, pyejeve, burimeve ujore, lumenjëve dhe pasurive nëntokësore
5. Hartim i projekteve të ndryshme për mbrojtje të ambientit
6. Hartimi i projekteve të ndryshme për pastrimin e lumenjëve nga ujërat e zeza

3.5.

4. Forma e realizimit të marrëveshtjes

Të dy palët duhet të i përmbahen kësaj marrëveshtje, dhe pajtohen që drejtorit perkatese te dy komunave te nenshkruajn Marrveshje te veqanta per nevoja te perbashketa.

5. Nëse ndonjera palë nuk është në gjendje të kryej obligimet, atëherë pala është e obliguar që palën tjetër ta njoftoj së paku 15 ditë para organizimit të puntorisë

6. Mosëmarrveshtjet

1. Ç' do mosmarrëveshje mbi interpretimin, menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim në mes dy komunave
2. Nëse ndonjera palë e marrëveshtjes heq dorë nga marrveshtja është e obliguar që së paku një muaj të njoftohet pala tjetës se ju keni hequr dorë nga marrëveshtja

7. Hyrja në fuqi e marrëveshtjes

Marrëveshtja hynë në fuqi ditën/datën e nënshkrimit nga dy kryetarët e komunave përkatëse

Me: 20.11.2020

Komuna e Hanit të Elezit

Kryetari z. Rufki Suma



Komuna e Kaçanikut

kryetari. z. Besim Ilazi

